

# **OLA 1 sh.p.k**

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

## **1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM**

OLA 1 Sh.p.k ("Shoqëria") u regjistrua në regjistrin tregtar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më datë 21 Mars 2003.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është prodhim dhe tregëtimi i artikujve promocionalë, veshjeve sportive, uniforma pune. Brandime dhe promocione të ndryshme

Adresa e shoqërisë është në fshatin Gropaj, Tiranë, Shqipëri.

Gjatë vitit 2020, shoqëria kishte numër mesatar punonjësish prej 130 vetë.

## **2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE**

### **2.1 Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyrat financiare, janë për qëllime të përgjithshme raportimi ligjor dhe janë përgatitur në përputhje me Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", të ndryshuar, dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri të publikuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit në Shqipëri dhe të përmirësuara me efekt nga 1 janar 2015.

### **2.2 Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3 Monedha funksionale dhe ajo e matjes**

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është njëkohësisht dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.4 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël nijhen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhme nëse ato ndikohen.

## **3. POLITIKAT KONTABËL**

Politikat kontabël të përmendura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

### **a. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në Lekë me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit nijhen përgjithësisht në fitime ose humbje.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Monedha	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1 EUR	123.70	121.77
1 USD	100.84	108.64



## **OLA 1 sh.p.k**

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përvçse kur shprehet ndryshe

### **b. Instrumenta financiare**

Instrumentat financiare jo-derivative përbëhen nga të drejta të arkëtueshme, mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, llogari të financimeve të brendshme, llogari të pagueshme dhe detyrime ndaj palëve të lidhura.

Të gjitha aktivet dhe detyrimet financiare njohen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi i që lidhet me to. Pas njohjes fillestare, instrumentat financiare jo-derivative njihen siç përkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur mbarojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin financier tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë mbarojnë, shfuqizohen ose anullohen.

#### *Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat bankare. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

#### *Të drejta të arkëtueshme*

Të drejtat e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e të drejtaave të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financier konsiderohen tregues që të drejtat e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provigjonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të skontuara me normën e interesit efektiv.

#### *Llogaritë e pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

#### *Vlera e drejtë*

Vlera e drejtë e vlerësuar për mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, të drejtat e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme i përafrohen vlerës së tyre kontabël.

### **c. Aktivet afatgjatë**

#### *Njohja dhe matja*

Zërat e aktiveve afatgjata materiale maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet e lidhura drejtpërdrejt me blerjen e aktivit.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra (përbërësit madhor) më vete të aktivit. Fitimet dhe humbjet në dispozicion të një zëri të aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël të elementit dhe njihen për vlerën neto në zérin "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave.



## **OLA 1 sh.p.k**

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përvçese kur shprehet ndryshe

### *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të aktivit nëse është e mundur që përfitime ekonomike të ardhshme të trupëzuara do të rrjedhin në kompani dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri.

Kostot e shërbimit të përditshëm të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

### *Amortizimi*

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur metodën lineare për përmirësimet e ambjenteve me qira dhe duke përdorur metodën e vlerës së mbetur për të gjitha aktivet e tjera, gjatë jetëgjatësisë së çdo pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale nga dita e parë e muajit pas muajit të blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi. Normat e amortizimit janë si më poshtë:

• Ndërtesa	vlera e mbetur me 5%
• Automjete	vlera e mbetur me 20%
• Pajisje Zyre & Informatike	vlera e mbetur me 20 – 25%
• Aktivet jomateriale	vlera e mbetur me 15%

### **d. Zhvlerësimi**

#### *Aktivet financiare*

Aktivi finansiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidence objektive të zhvlerësimit si pasojë e një apo disa ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, të cilat kanë ndikim në flukset monetare që rrjedhin nga aktivi finansiar dhe që mund të maten në mënyrë të besueshme.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi finansiar i matur me koston e amortizuar, llogaritet si diferençë mes vlerës së tij të akumular dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare, të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet e rëndësishme financiare testohen individualisht për zhvlerësim në mënyrë periodikë. Pjesa e mbetur e aktiveve shqyrtohen në grupime që kanë karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit.

Një humbje nga zhvlerësmi anullohet nëse ky anulim lidhet në mënyre objektive me një ngjarje të ndodhur pasi është njojur kjo humbje. Për aktivvet financiare të llogaritura me koston e amortizuar, anulimi njihet në pasqyrën e të ardhurave.

### **e. Njohja e të ardhurave**

Të ardhurat llogariten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqëson shumën e arkëtueshme për shitjen e mallrave në rrjedhën normale të biznesit, duke marrë parasysh skontimet dhe uljet e ofruara. Të ardhurat njihen kur ofrohen shërbimet.



## **OLA 1 sh.p.k**

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përvçëse kur shprehet ndryshe

### **f. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga kurset e këmbimit. Shpenzimet financiare përfshijnë humbjet nga kurset e këmbimit.

### **g. Tatimi mbi fitimin**

Tatami mbi fitimin përfshin tatimin aktual i cili njihet në "Pasyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve". Taktimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi të ardhurat e tatushme për periudhën, duke përdorur normat e tatuara të aplikuara në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare.

### **h. Shpërblimet e punonjësve**

*Kontributet e detyrueshme shoqërore*

Kompania nuk bën provizone dhe nuk ka detyrime për pensionet e punonjësve mbi kontributet e paguara në Institutin Shqiptar të Sigurimeve Shoqërore. Kostot respektive në emër të kompanisë njihen në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, në momentin që ndodhin.

### **i. Vlerësimet dhe gjykimet e kontabilitetit**

Vlerësimet dhe gjykimet shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të mëvonshme që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethanat aktuale.

Vlerësimet dhe hipotezat që mbartin riskun e shkaktimit të një rregullimi material në vlerat e mabrtura të aktiveve dhe detyrueshme për vitin e ardhshëm fiskal, janë të listuara më poshtë.

*Taksat mbi të ardhurat*

Kompania është subjekt i taksave mbi të ardhurat në Shqipëri. Për të përcaktuar nivelin e taksave të shtyra mbi të ardhurat nevojitet një gjykim i kujdeshëm. Ka një numër transaksione të llogaritjesh për të cilat një përcaktim përfundimtar i taksave është i pasigurt. Kompania njeh detyrimet për çështje të pritshme që lidhen me auditimin fiskal bazuar në vlerësimet nëse do të ketë taksa shtesë për t'u paguar.



## **OLA 1 sh.p.k**

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përvçse kur shprehet ndryshe

### **4. PARA NË ARKË DHE BANKË**

Paraja cash dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si vijon

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
<b>I. Para në arkë</b>		
Në monedhë vendase	2,064,705	1,141,355
Në monedhë të huaj	2,062,231	31,943
	2,474	
<b>II. Para në bankë</b>	<b>5,088,591</b>	<b>966,183</b>
Në monedhë vendase	3,113,316	821,608
Në monedhë të huaj	1,975,276	144,575
<b>Totali i parasë në arkë dhe bankë</b>	<b>7,153,297</b>	<b>2,107,538</b>

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj që shoqëria ka pranë bankave të nivelit të dytë në Shqipëri si dhe gjëndja e arkës në datën e raportimit.

### **5. LLOGARI TË ARKËTUESHME**

Llogari të arkëtueshme nga klientët në datën 31 dhjetor 2020 dhe 2019 përbëhen si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Të arkëtueshme nga klientë	55,678,232	45,573,477
<b>Llogari të arkëtueshme neto</b>	<b>55,678,232</b>	<b>45,573,477</b>

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë të arkëtueshme nga klientët për shitjen e mallrave dhe produkteve të tjera nga aktiviteti kryesor i Shoqërisë.

### **6. LLOGARI TË TJERA TË ARKËTUESHME**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Parapagime në doganë	24,907	195,496
TVSH e arkëtueshme	-	1,569,270
<b>Totali</b>	<b>24,907</b>	<b>1,764,766</b>

### **7. INVENTARË**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Lëndë e parë	161,190,070	171,374,902
Mallra për shitje	15,104,910	14,983,845
Produkte të gatshme	5,982,799	5,016,030
<b>Totali</b>	<b>182,277,779</b>	<b>191,374,777</b>



## OLA 1 sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përvëçse kur shprehet ndryshe

### 8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

	Toka dhe ndërtesa	Impianete dhe makineri	Të tjera	Totali	Kosto	Programe & Licensa	Totali
<b>Kosto</b>							
Më 1 janar 2019	81,064,956	110,908,795	24,243,218	216,216,969	Më 1 janar 2019	1,582,267	1,582,267
Shtesa	1,316,500	288,430	623,445	2,228,375	Shtesa	-	-
Pakësimë	-	-	-	-	Pakësimë	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>82,381,456</b>	<b>111,197,225</b>	<b>24,866,663</b>	<b>218,445,344</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,582,267</b>	<b>1,582,267</b>
Shtesa	1,016,896	2,224,530	5,733,260	8,974,686	Shtesa	-	-
Pakësimë	-	-	-	-	Pakësimë	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>83,398,352</b>	<b>113,421,755</b>	<b>30,599,923</b>	<b>227,420,030</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,582,267</b>	<b>1,582,267</b>
<i>Zhvlerësim i akumuluar</i>							
Më 1 janar 2019	(54,568)	(59,072,691)	(16,926,751)	(76,054,010)	Më 1 janar 2019	(850,730)	(850,730)
Shpenzime për vitin	-	(6,331,313)	(1,539,690)	(7,871,003)	Shpenzime për vitin	(109,730)	(109,730)
Pakësimë	-	-	-	-	Pakësimë	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(54,568)</b>	<b>(65,404,004)</b>	<b>(18,466,441)</b>	<b>(83,925,013)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(960,460)</b>	<b>(960,460)</b>
Shpenzime për vitin	-	(6,397,361)	(1,389,099)	(7,786,460)	Shpenzime për vitin	(93,271)	(93,271)
Pakësimë	-	-	-	-	Pakësimë	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(54,568)</b>	<b>(71,801,365)</b>	<b>(19,855,540)</b>	<b>(91,711,473)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(1,053,731)</b>	<b>(1,053,731)</b>
<i>Vlera e mbartur</i>					<i>Vlera e mbartur</i>		
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>82,326,888</b>	<b>45,793,221</b>	<b>6,400,222</b>	<b>134,520,331</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>621,807</b>	<b>621,807</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>83,343,784</b>	<b>41,620,390</b>	<b>10,744,383</b>	<b>135,708,557</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>528,536</b>	<b>528,536</b>

### 9. AKTIVET AFATGJATA JO MATERIALE

	Toka dhe ndërtesa	Impianete dhe makineri	Të tjera	Totali	Kosto	Programe & Licensa	Totali
<b>Kosto</b>							
Më 1 janar 2019	81,064,956	110,908,795	24,243,218	216,216,969	Më 1 janar 2019	1,582,267	1,582,267
Shtesa	1,316,500	288,430	623,445	2,228,375	Shtesa	-	-
Pakësimë	-	-	-	-	Pakësimë	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>82,381,456</b>	<b>111,197,225</b>	<b>24,866,663</b>	<b>218,445,344</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>1,582,267</b>	<b>1,582,267</b>
Shtesa	1,016,896	2,224,530	5,733,260	8,974,686	Shtesa	-	-
Pakësimë	-	-	-	-	Pakësimë	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>83,398,352</b>	<b>113,421,755</b>	<b>30,599,923</b>	<b>227,420,030</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>1,582,267</b>	<b>1,582,267</b>
<i>Zhvlerësim i akumuluar</i>							
Më 1 janar 2019	(54,568)	(59,072,691)	(16,926,751)	(76,054,010)	Më 1 janar 2019	(850,730)	(850,730)
Shpenzime për vitin	-	(6,331,313)	(1,539,690)	(7,871,003)	Shpenzime për vitin	(109,730)	(109,730)
Pakësimë	-	-	-	-	Pakësimë	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(54,568)</b>	<b>(65,404,004)</b>	<b>(18,466,441)</b>	<b>(83,925,013)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>(960,460)</b>	<b>(960,460)</b>
Shpenzime për vitin	-	(6,397,361)	(1,389,099)	(7,786,460)	Shpenzime për vitin	(93,271)	(93,271)
Pakësimë	-	-	-	-	Pakësimë	-	-
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(54,568)</b>	<b>(71,801,365)</b>	<b>(19,855,540)</b>	<b>(91,711,473)</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>(1,053,731)</b>	<b>(1,053,731)</b>
<i>Vlera e mbartur</i>					<i>Vlera e mbartur</i>		
<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>82,326,888</b>	<b>45,793,221</b>	<b>6,400,222</b>	<b>134,520,331</b>	<b>Më 31 dhjetor 2019</b>	<b>621,807</b>	<b>621,807</b>
<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>83,343,784</b>	<b>41,620,390</b>	<b>10,744,383</b>	<b>135,708,557</b>	<b>Më 31 dhjetor 2020</b>	<b>528,536</b>	<b>528,536</b>



## **OLA 1 Sh.p.k**

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përvçse kur shprehet ndryshe

### **10. TË PAGUESHME NDAJ FURNITORËVE**

Të pagueshme ndaj furnitorëve më datë 31 dhjetor 2020 dhe 2019 janë si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Furnitorë për mallra dhe shërbime	41,275,428	78,668,587
<b>Totali</b>	<b>41,275,428</b>	<b>78,668,587</b>

### **11. TË PAGUESHME NDAJ PUNONJËSVE DHE SIGURIMEVE**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Pagat e punonjësve	7,222,785	7,001,409
Kontributet e sigurimeve shoqërore & shëndetësore	1,036,647	1,124,403
<b>Totali</b>	<b>8,259,432</b>	<b>8,125,812</b>

### **12. TË PAGUESHME PËR DETYRIME TATIMORE**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Tatimi mbi vlerën e shtuar	1,830,018	-
Tatimi mbi fitimin	550,009	107,516
Tatimi i mbajtur në burim	50,777	40,278
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	30,464	29,814
<b>Totali</b>	<b>2,461,268</b>	<b>177,608</b>

### **13. KAPITALI I PAGUAR**

Më 31 dhjetor 2020 aksionari të Shoqërisë janë Z. Artur Kalemi dhe Z. Sokol Kalemi me nga 50% pjesëmarrje në kapital. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2020 është 44,000,000 LEK (2019: 44,000,000 LEK) i përbërë nga 2 kuota me vlerë nominale 22,000,000 LEK secila.

### **14. REZERVA**

Rezerva të krijuara nga Shoqëria më 31 dhjetor 2020 kanë një vlerë prej 6,550,091 LEK (2019: 143,666 LEK).



## OLA 1 Sh.p.k

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbyllt më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përvçse kur shprehet ndryshe

### 15. TË ARDHURAT

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Shitje mallrash	173,795,392	176,204,429
Të ardhura nga qiraja, shitje asetesh etj.	1,769,896	1,556,500
Dëmshpërblime të marra	2,766,726	887,300
<b>Totali</b>	<b>178,332,014</b>	<b>178,648,229</b>

Dëmshpërblimet e marra përfaqësojë shumat e kompensuara nga kompanitë e sigurimit lidhur me dëmtimet e aseteve të shoqërisë.

Të ardhurat e bilancit nuk përputhen me ato të deklaruara në FDP-të në e-tax në [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al), për shumën prej 425,286 lekë të cilat përfaqësojnë paradhenje te arketuara per shitje te mevonshme sic paraqitet zërin arkëtime në avancë për porosi të pasqyrës së pozicionit financiar (faqe 5).

### 16. SHPENZIME OPERATIVE

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Energji, karburant etj.	4,042,357	4,746,597
Qira	3,756,944	2,974,584
Mirëmbajtje dhe riparime	3,362,403	1,559,726
Shpenzime të tjera administrative	3,320,647	2,178,688
Shërbime bankare	1,387,777	1,024,663
Shpenzime telekomunikacioni dhe postare	1,232,520	1,228,741
Gjoba dhe penalitete	1,114,172	67,211
Sigurime për mallrat dhe asetet	1,067,390	1,052,810
Taksa dhe tarifa të ndryshme	821,423	720,856
Shpenzime transporti	679,158	213,002
Shpenzime për pritje	12,076	252,520
Shpenzime për reklama	-	64,905
Shpenzime për udhëtime e dieta	-	16,667
<b>Totali</b>	<b>20,796,867</b>	<b>16,100,970</b>

### 17. SHPENZIME FINANCIARE

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Fitime nga kurset e këmbimit	(824,812)	(1,747,361)
Humbje nga kurset e këmbimit	777,339	691,913
<b>Totali i humbjeve nga kurset e këmbimit</b>	<b>(47,473)</b>	<b>(1,055,448)</b>
Të ardhura nga interesat	-	-
Shpenzime për interesat	2,136,722	2,623,971
<b>Totali i shpenzimeve për interesat</b>	<b>2,136,722</b>	<b>2,623,971</b>
Shpenzime financiare neto	2,089,249	1,568,523



## **OLA 1 Sh.p.k**

Shënimet për Pasqyrat Financiare për vitin që mbylllet më 31 Dhjetor 2020

Shumat janë në LEK, përvçe kur shprehet ndryshe

### **18. TATIM FITIMI**

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>9,042,557</b>	<b>7,548,832</b>
Shpenzime të pazbritshme	1,114,172	67,211
<b>Fitimi /(humbja) tatimore për vitin</b>	<b>10,156,729</b>	<b>7,616,043</b>
Tatimi mbi fitimin 15%	(1,523,509)	(1,142,406)
<b>Fitimi NETO i vitit</b>	<b>7,519,048</b>	<b>6,406,425</b>

Shpenzimet e pazbritshme lidhen me shpenzime që sipas Ligjit Shqiptar nuk mund t'i zbriten llogaritjes së fitimit/humbjes së tatueshme.

	<b>31 Dhjetor 2020</b>	<b>31 Dhjetor 2019</b>
Gjoba dhe penalitete	1,114,172	67,211
<b>Totali</b>	<b>1,114,172</b>	<b>67,211</b>

Norma efektive e tatimit mbi fitimin paraqitet si më poshtë:

	<b>31 dhjetor 2020</b>	<b>Norma efektive tatimore</b>	<b>31 dhjetor 2019</b>	<b>Norma efektive tatimore</b>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>9,042,557</b>		<b>7,548,832</b>	
Tatimi mbi fitimin 15%	1,356,384	15.00%	1,132,325	15.00%
Shpenzime të pazbritshme	167,126	1.85%	10,082	0.13%
<b>Totali i tatimit mbi fitimin</b>	<b>7,519,048</b>	<b>16.85%</b>	<b>8,691,238</b>	<b>15.13%</b>

### **19. NGJARJE PAS PERIUDHËS RAPORTUESE**

Nuk ka ngjarje të rëndësishme të ndodhura pas datës së mbylljes së pasqyrave financiare që kërkon rregullime të pasqyrave financiare ose dhënie të shpjegimeve plotësuese për to.

